

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Për çfarë i shpenzojnë paratë shqiptarët dhe europianët: 29% për ushqime, gati trefishi i BE-së
ADRESA	https://www.gazetatema.net/ekonomia/per-cfare-i-shpenzojne-parate-shqiptaret-dhe-europia-net-29-per-ushqime--i584862
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 06:27:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 06:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a73a58b6eb4c009d50be336e8989e904d00ff708f96064cf797be623240ae00a
TEKSTI	e28d63ec4f96f6cde394e16f6dc5cd26895cec65c3a054058bbfb9e5cb5d26f7
PAMJA	476e176c7444c6304b3e60a2b192ea7a95a214f14d16f4df9ce76639bf9556f8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	decf6fca83fb34c2863fd8be168782cb38f15cbdf9e6bfdbf2f6772ce5182dfb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/decf6fca83fb34c2863fd8be168782cb38f15cbdf9e6bfdbf2f6772ce5182dfb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Shperthimi ne karburantin te "Bryll", reason Policia: Tre punonjes te plagosur jashte rrezikut per jetenKaos ne aeroportet britanike, mbi 600 fluturime anulohen pas defektit ne sistemin e kontrol

Për çfarë i shpenzojnë paratë shqiptarët dhe europianët: 29% për ushqime, gati trefishi i BE-së

9 Shtator 2026, 08:35Ekonomia TEMA



 Për çfarë i shpenzojnë paratë shqiptarët dhe

Shqiptarët kanë një nivel konsumi individual shumë më të ulët se mesatarja europiane, por për ushqimet shpenzojnë pothuajse po aq euro për frymë sa qytetarët e Bashkimit European. Ky kontrast bën që ushqimet të marrin një pjesë shumë më të madhe të buxhetit të konsumit në Shqipëri.

Sipas të dhënave të Eurostat për vitin 2025, konsumi individual aktual në Shqipëri arrin në 8,656 euro për banor në vit, ose rreth 20.3 miliardë euro në shkallë vendi. Mesatarja e BE-së është 27,463 euro për frymë, çka do të thotë se të ardhurat për frymë të një shqiptari janë vetëm rreth 32% të një banori në një nga vendet e Bashkimit European.

Diferenca më e fortë shfaqet te ushqimet, për peshën ndaj totalit, por jo për vlerën, një tregues i varfërisë në vend. Nga 8,656 euro që përbëjnë konsumin vjetor për banor në Shqipëri, 2,513 euro shkojnë për ushqime dhe pije joalkoolike. Në total, kjo kategori përllogaritet në rreth 5.9 miliardë euro, ose 29% të gjithë konsumit individual.

Në BE, për ushqime shpenzohen mesatarisht 2,847 euro për frymë, pra vetëm rreth 13% më shumë në vlerë absolute se në Shqipëri. Por, për shkak të të ardhurave shumë më të larta në dispozicion, që u jep më shumë mundësi të konsumojnë në kategoritë e tjera, pesha e tyre në shportën europiane është vetëm 10.4%. Ushqimet zënë në Shqipëri një pjesë 2.8 herë më të lartë se në mesataren e BE.

Pas tyre, ndër kategoritë me peshën më të madhe në Shqipëri janë shpenzimet për banesën dhe energjinë. Për banesën, ujin, energjinë elektrike, gazin dhe lëndët e tjera djegëse llogariten 1,172 euro për banor, ose rreth 2.75 miliardë euro gjithsej,. Kjo kategori merr 13.5% të konsumit, më pak se niveli prej 18.8% në BE.

Edhe mobilimi, pajisjet shtëpiake dhe mirëmbajtja e banesës kanë peshë dukshëm më të lartë në Shqipëri. Për këtë grup shpenzohen 751 euro për banor, ose rreth 1.77 miliardë euro në total. Kategoria përbën 8.7% të konsumit, kundrejt vetëm 3.8% në BE.

Në të kundërt, shëndetësia merr një pjesë më të vogël të konsumit shqiptar. Eurostat llogarit 662 euro për frymë, ose rreth 1.56 miliardë euro në nivel vendi, ekuivalente me 7.6% të totalit. Në Bashkimin European, pesha arrin në 13.4%.

Edhe transporti zë më pak peshë në strukturën shqiptare: 576 euro për banor dhe rreth 1.36 miliardë euro në total, ose 6.7%, përkundrejt 9.9% në BE. Për restorante dhe akomodim përllogariten 427 euro për frymë, ndërsa pjesa ndaj konsumit është 4.9%, krahasuar me 7.2% në Union.

Për veshje dhe këpucë, një shqiptar shpenzon 205 euro në vit (2.4% e totalit, përkundrejt 881 euro mesatarja e BE-së (3.2% e totalit).

Një nivel i lartë shpenzimesh raportohet për zërin “Rekreacion, sport dhe kulturë”, ku përfshihen dhe paketat turistike. Në Shqipëri përllogariten 1,162 euro për frymë, me një vlerë totale prej rreth 2.73 miliardë eurosh, nga 1900 euro për frymë mesatarja e BE-së. Pësja arrin në 13.4%, pothuajse dyfishi i mesatares europiane prej 6.9% me një banor të Ber-së që shpenzon mesatarisht 2730 euro në vit për transport.

Ky zë në pamje të parë duket shumë i lartë, por më shumë sesa shpenzime të larta për argëtim. Arsyeja kryesore është mënyra si ndërtohen llogaritë kombëtare. INSTAT, i cili është burimi i parë i të dhënave për Shqipërinë, shpjegon se konsumi final i familjeve nuk merret vetëm nga Anketa e Buxhetit, por rindërtohet nga një numër burimesh administrative dhe ekonomike.

Pikërisht për grupin “Rekreacion dhe kulturë”, INSTAT thotë se paketat turistike vlerësohen duke ekstrapoluar të dhënat sipas prodhimit të sektorit të akomodimit dhe ushqimit, ndërsa pajisjet audiovizive, pajisjet e mëdha për rekreacion, artikujt rekreativë, kopshtaria, kafshët shtëpiake, librat e kancelaria vlerësohen edhe nga prodhimi i tregtisë. Pajisjet audio/video janë vlerësuar edhe nga importet, duke u shtuar TVSH-ja dhe marzhi tregtar. Në kontrast, Anketa e Buxhetit të Familjeve 2024, ku familjet raportojnë shpenzimet e tyre, e nxjerr rekreacionin dhe kulturën vetëm 2.6%.

Eurostat shpjegon se treguesi i konsumit individual aktual është më i gjerë se pagesat që familjet bëjnë drejtpërdrejt nga xhepi, pasi përfshin edhe shërbime individuale të financuara nga shteti sidomos në fusha si shëndetësia dhe arsimi / Monitor

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Shqipëria pjesë e Kodit Global- Nga të dhënat te financimi, forcohet mbështetja për gratë sipërmarrëse](#)

15:20 Ekonomia / 1 koment

[Fatura e aksidenteve - AMF: Kompanitë e sigurimit paguan mesatarisht 175 mijë lekë për dëmet motorike](#)

16:10 Ekonomia / 2 komente

[Shqiptarët paguan 70 mln euro për të rivlerësuar pronat](#)

15:20 Ekonomia / 3 komente

[Kreditë nën monitorim: Historiku financiar i qytetarëve dhe bizneseve në një sistem të ri](#)

14:20 Ekonomia

[Transporti, sfida e tranzicionit - Plani i ri për dekarbonizimin: Elektrifikim, transport publik dhe hekurudhor](#)

13:50 Ekonomia / 2 komente

[Më në fund kontroll real i çmimeve?](#)

20:05 Ekonomia / 7 komente

[Dy anët e një monedhe në rënie, ekspertët: Zhvleftësimi i euros me humbje dhe përfitime. Të përgatitemi për përdorimin e një paraqe të vetme](#)

17:15 Ekonomia / 9 komente

[Shqipëria në BE, sa do të paguajë dhe sa do të përfitojë? Në buxhetin e Unionit do të derdhet një kontribut, por përfitimet pritet të jenë më të larta](#)

13:05 Ekonomia / 2 komente

[Nga SEPA te pagesat e menjëhershme, Guvernatori Sejko nga konferenca në Malin e Zi tregon hapat e Shqipërisë drejt Europës](#)

11:45 Ekonomia / 2 komente

[Shërbim derë më derë, Kadastra përfundon evidentimin e banesave informale në zonën e Selitës së Madhe në Tiranë, afishohet lista \(Emrat\)](#)

18:38 Ekonomia / 4 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika / 48 komente

[Përplasja mes biznesmenëve për pronën në Palasë, Filip Ça...](#)

10:10 Sociale / 25 komente

[FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...](#)

17:35 Politika / 92 komente

[Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...](#)

14:50 Politika / 10 komente

[Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...](#)

19:40 Politika / 74 komente

Blog Tema

[“Respekte”, z. Korrupsion!](#)

22:30 Blog

[Përse dështoi Reforma në Drejtësi](#)

17:10 Blog / 30 komente

[Pelegrinazhi amerikan i Berishës i duhet vetëm Berishës](#)

16:24 Blog

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)

- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.